REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 130/17
Data/Datum 12.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Ministria e Puneve te Brendeshme".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **130/17**, parashtruar nga OE **," Astraplan" shpk-Prishtinë,**		
Datë:	**12.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521***.. të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Ministria e Puneve te Brendeshme"**, dhe me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"Astraplan" shpk-Prishtinë,** me nr.**130/17,** të datës **28.04.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Ministria e Puneve te Brendeshme".**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - **"Astraplan" shpk- Prishtinë,**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		03.05.2017		03.05.2017		12.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

OSHP më datën **28.04.2017,** ka pranuar ankesën me nr. **130/17** nga OE "***Astraplan***" **sh.p.k**-Prishtinë, kundër AK – ***Ministria e Punëve të Brendshme***, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521***.

Konform nenit 113.1, të LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – "**Ministria e Punëve të Brendshme".**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , "*Astraplan*"- sh.p.k-Prishtinë

*Pikat e Ankesës nga OE "**Astraplan**"* **sh.p.k - Prishtinë** *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni - 7 i LPP-së nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim

Neni - 56 i LPP-së nr.04/L-042, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Nëni - 55 i LPP-së nr.04/L-042-Menyrat e komunikimit

Neni - 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni - 64 i LPP-së nr.04/L-042-Dëshmitë e kërkesave

Neni - 65 i LPP-së nr.04/L-042-Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni - 65, Pika 4.3 dhe Pika 4.8

Neni - 66 i LPP-së nr.04/L-042- Përshtatshmëria Profesionale

Neni - 69 i LPP-së nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni -72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 39.8 te RRUOPP me tabelën e cekur ne nenin 39.8 kur ndonjë dokument i kërkuar nuk i plotëson kriteret, shih tabelën ne faqen 80 te RRUOPP se nuk ka te drejte AK-ja te kërkoj sqarime.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Fillimisht autoriteti kontraktues i MPB-se ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-s me nr: PSH. nr.:39, 40, 41/17, për arsye se në vendim nuk është kërkuar që konform Nenit 72 AK-ja të

kërkoj sqarime OE Mercon Company, por ankesën ja aporvon si pjesërisht të bazuar dhe atë vetëm për piken që ka të bëj me buxhetin për aktivitetin në fjalë. Me këtë fakte OE të rekomanduar për kontrate edhe OSHP-ja e vlerëson se me mos përgjigjen në kërkesën e AK-s më tutje nuk i plotëson kërkesat, citojmë nenin e RRUOPP- NENI 39.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet, dhe pikërisht për ketë në vendimin PSH. nr.:39, 40, 41/17 OSHP nuk thotë në asnjë pike se OE Mercom Company dhe EUROPA PARTNERS SHPK & ABC janë të përgjegjshëm ose të u kërkohen për së dyti informata sqaruese. Në këtë raste i bije që OE Mercom Company dhe EUROPA PARTNERS SHPK & ABC të dorëzoj modifikoj ofertën për së dyti herë, që në baze të LPP-se nuk lejohet që të dorëzohen modifikohet oferta e dorëzuar me dokumente të reja që më parë nuk kanë qenë në dosje tenderit siç janë disa deklarata e disa dokumente tjera që janë sjellë nga OE i rekomanduar për kontrate pas kërkesës për sqarime, dokumente shtese rreth 22 faqe, gjë që është në kundërshtim me LPP-në.

2. AK i MPB-s ka bërë shkelje të nenit 58 të pikës 3 të Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, po e citoj nenin në çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër dhe nga komisioni i hapjes se ofertave, ku nga komisioni nuk janë nënshkruar fare paramasa dhe parallogaria.

3. OE i rekomanduar për kontratë në kërkesën e dërguar nga AK-ja në herën e parë nuk është përgjigjurgjoja se "nuk" e ka pranuar emailin, ndërsa për çudi në herën e dyte në të njëjtin email e pranoj dhe u përgjigj, kjo tregon qarte se edhe herën e parë e ka pranuar emailin ku këtë e ka vërtetuar edhe departamenti për administrim të sistemeve dhe komunikimeve në MPB dhe ASHI-MAP dëshmi këto te ofruara nga përfaqësuesja e MPB-s në seancën e OSHP-se të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të vërtetuar se ju ka dërguar emailat në adresat e sakta.

4. AK I MPB-s ka bërë shkelje të nenit 59 te LPP-se pasi nuk ka bërë vlerësim objektiv pasi OE Mercom Company dhe OE EUROPA PARTNERS SHPK & ABC nuk ka qenë i përgjegjshëm pra nuk ka qenë Tenderë I përgjegjshëm sipas kritereve të përcaktuar në Dosjen e tenderit. Ne bazë të nenit 59 pika 4 pra çdo Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit saktësisht pika 9.1 dhe 9.2. Pra ky AK ka bere shkelje te pikës 9.1 dhe 9.2 te dosjes se tenderit, nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet, kjo do te thot se me mos përgjigje nuk janë plotësuar as kërkesat sipas FTD-s.

5. Dokumenti i prezantuar nga OE Mercom Company se gjoja e ka marre nga Yahoo, kjo shkresë është edhe në kundërshtim me NENIN 4 (Gjuhet Zyrtare) të Rregullores së punës e OSHP-s Nr. 02/2015 si dhe Nr. 1/2017, piken 1 dhe 2 (1) Gjuhët zyrtare të OSHP-së, janë gjuha Shqipe dhe Serbe. (2) Palët e procedurës së shqyrtimit, do të prezantojnë përkthimin e certifikuar në gjuhën Shqipe ose Serbe të çdo dokumenti të lëshuar në gjuhë të huaja, i cili konsiderohet të jetë i rëndësishëm për marrjen e vendimit në një rast të veçantë për OSHP-né. Ne kemi dyshimet Tona se me këtë është ofruar dëshmi e rreme sepse ajo shkresë nuk ka qen origjinal me aq sa kemi pare në seancën e kaluar dhe as e vërtetuar nga operatori Yahoo, kërkojmë nga eksperti shqyrtues që të e analizoj atë dëshmi të dorëzuar se në cilën gjuhe është si dhe përmbajtjen e saj, dorëzimi i dëshmive të rreme ose të falsifikuara i plotëson kushtet për futjen në listën e zezë të OSHP-s.

6. OE i rekomanduar për kontrate nuk ka të vulosura dhe të nënshkruara specifikacionet teknike, kjo është në kundërshtim me kërkesat e FTI)-s, ku secila flet duhet të nënshkruhet dhe vuloset.

7. OF i rekomanduar për kontrate ka dështuar ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/I-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092, Neni 65, pika b) Një dokument

nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës. Në dokumentin e dorëzuar në AK, shënon se OF është në obligime financiare pran ATK-s qe do te thotë se ka borgje ndaj ATK-s, kjo është në kundërshtim të plotë me dhe me kërkesën e FTD-s, citojmë piken b) Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni më vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. (mbarim Citati),

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, saktësisht Pika 4. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik është:

Pika 4.3 aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se Operatori ekonomik më parë ka qenë i paaftë që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor:

Pika 4.8, aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovës (Zbarizi cilati i Pikës 4.3 dhe 4.8 te Nenit 65 te LPP-s)

Nga kjo kuptohet qarte se OE i rekomanduar për kontrate është ne vonese dhe për ata edhe ka bërë marrëveshje, për njoftimin të PSH dhe ekspertit shqyrtues, marrëveshja bëhet vetëm e vetëm qe mos të bllokohen llogarit bankare të biznesit në fjalë dhe mos të shndërrohet nga borgji në vepër penale, sepse sipas ligjit te ATK-s, mos shlyerja e obligimeve ndaj ATK-s arrin deri në vepër penale dhe dënohet me burg. -NGA KREJT KJO DEL SE OE MERCOM COMPANY ESHTE I PA PERGJEGJSHEM.

EUROPA PARTNERSSHPK & ABC nuk i plotëson kërkesat e FTD-se dhe plotësisht është i pa përgjegjshëm, për arsyet si ne vijim:

1. Vendimin e OSHP-s me nr: PSH. nr.:39, 40, 41/17, as për ketë OE nuk ka kërkuar të kërkohen sqarime Nenit 72 AK-ja, ku me këtë fakte këtë OE edhe OSHP-ja e vlerëson se me mos përgjigjen në kërkesën e AK-s me tutje nuk i plotëson kërkesat, citojmë nenin e RRUOPP- NENI 39.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet. Në këtë raste i bije qeëky OE të dorëzoj-modifikoj ofertën për se dyti here, që në bazë të LPP-se nuk lejohet që të dorëzohen-modifikohet oferta e dorëzuar me dokumente të reja që me parë nuk kanë qenë në dosje. 2. EUROPA PARTNERS SHPK & ABC nuk i plotësojnë kërkesat e FTD-se pasi që

nuk i kanë të vulosura dhe të nënshkruara çmimet-paramasën dhe parallogarinë. Ne bazë të RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK të nenit 18.3 Autoriteti Kontraktues -komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje pasi nuk ka eliminuar një kompani që nuk i ka plotësuar kushtet e tenderit oferta financiare e tenderit e pa nënshkruar nga po e citojmë piken 18.3 ; OE duhet të plotësoj dhe të nënshkruaj formularin (dy pjesët), sepse në qoftë se formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka ofertë të tij financiare. Pra Oferta financiare e EUROPA PARTNERS SHPK & ABC është e pa nënshkruar dhe pa vulosur pasi nuk janë të nënshkruar as nga komisioni i hapjes vetëm nga një përfaqësues i OE, që në baze të LPP-së duhet të eliminohet menjëherë.

Shih foton e më poshtme marre nga RRUOPP që ka hyre në fuqi me datën 01.11.2016 faqe 81, kjo është lista e cila sqaron se si duhet të vlerësohet një tender.

Lista e çmimeve është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar	Kusht administrativ

por nuk është nënshkruar	informacion të mëtutjeshëm	

3. Ky OE nuk e ka të plotësuar formularin e tenderit ku në pjesën e personit të autorizuar në rast të konzorciumit nuk është i plotësuar emri i personit të autorizuar e as nuk është i vulosur e as i nënshkruar, pra formulari i tenderit është i pa plotësuar. 4. I mungon Lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit-nuk është në përputhje me kërkesën e FTD-s 5. Ky OE ka dështuar të plotësoj Nenin 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale; piken 2) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku dy kontrata të ndërtimeve ose renovimeve, të realizuara në tri vjetët e shkuara (2013, 2014, 2015). dhe 9.2 te FTD-s- Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2) Listën e kontratave të punëve që specifikojnë: punët e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmi certifikatën (certifikatat) e ekzekutimit të mirë (kopje) Ose referencë (kopje) ose raport të pranimit teknik (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i punëve për kontratat e cekura në listë.

Të gjitha kontratat e përfunduara ky konzorcium i ka në infrastrukture rrugore, ndërsa disa kontrata me disa OE të Mitrovicës veriore (kompani serbe) i ka pa procese të pranimit teknik dhe pa referenca.

Gjithashtu i Autoriteti Kontraktues Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të bëjë edhe vlerësimin në përputhje me neni 69 dhe me RRUOPP me tabelën e cekur në nenin 39.8 kur mungon Lista origjinale duhet të eliminohet kompania

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/çertifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezentuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dërzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm	69
Dëshmit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbush kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm	68
Formulari i tënderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është kërkuar por nuk është nënshkruar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm	Kusht administrativ

Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, nga Paneli Shqyrtues në OSHP kërkojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës Sonë të zbatoj Nenin 104 të LPP-së si dhe të bëjë sintezën dhe analizën e dyshimeve, kërkesave dhe pretendimeve të ngritura në këtë ankesë dhe se këtë aktivitet prokurimi ta kthej në RI-VLERESIM pasi që e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Demet material:

Dëmtimi i imazhit të kompanisë, dëmtimi moral dhe humbja e kohës, shpenzimet material në përgatitjen e ofertës,

Fitim i humbure sepse po të ishte vlerësimi real do të ishim fituesit e kësaj oferte, pasi qe i plotësojmë

të gjitha kërkesat e tenderit dhe jemi oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	07.11.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	29.11.2016
Data e hapjes së ofertave	29.11.2016
Data e njoftimit tëanulimit në faqen e Krpp-së :	27.01.2017
Data e njoftimit për dhënie të kontratës pas rivlersimit të ofertave	14.04.2017
Vlera e parapare per AP	399,587.83€

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Dëshmia e kërkuar dokumentare: a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).
Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit.	c. Vërtetimin nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentare: a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.	Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës te përgjegjshëm.
b. Regjistrimi për numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje). b. Certifikatë me numër fiskal (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: NA	
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Personel prej minimumi 4 (katër) inxhinierëve të cilët drejtpërdrejt janë	***Dëshmia e kërkuar dokumentare: NA*** ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***

përgjegjës për ekzekutimin-realizimin e aktiviteteve të renovimit, të prezantohen: a. Menaxheri i projektit, duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv ose Inxhinier i diplomuar i arkitekturës - 3 vjet përvojë pune pas diplomimit; b. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; c. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; 2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku dy kontrata të ndërtimeve ose renovimeve, të realizuara në tri vjetët e shkuara (2013, 2014, 2015).	Personel prej minimumi 4 (katër) inxhinierëve: a. Menaxheri i projektit, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv ose inxhinier i diplomuar i arkitekturës - 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. - vendimin për menaxher të projektit. B05 Njoftim per Kontrat elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; b. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. c. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. 2. Listën e kontratave të punëve që specifikojnë: punët e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmi certifikatën (certifikatat) e ekzekutimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje) ose raport të pranimit teknik (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i punëve për kontratat e cekura në listë.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje

1.	"Tekno ing consulting" shpk	Prishtinë	354,661.98 €	JO
2.	"Europa Partners" shpk	Prishtinë	325,786.00 €	JO
3.	"Olti Trasing" shpk	Prishtinë	338,503.50 €	JO
4.	"Mercom Company" shpk	Prishtinë	306,724.72 €	JO
5.	"Astraplan" shpk	Prishtinë	367,182.43 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 29.11.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë pesë (5) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Gëzim Qorraj
- - Anëtar i komisionit - Lavdërim Bullatovci
- - Anëtar i komisionit – Iliriana Rexhepi

Data e mbarimit të vlerësimit: 29.12.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....23.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Nga tenderet e përgjegjëshëm që kanë ofertuar për "Ndërtimi i aneks objektit të Agjensise së Kosoves për Forenzikë – Faza II", pasi që kriter për dhënjen e kontratës është tenderi i përgjegjëshëm me cmimin më të ulët, komisioni i vleresimit me rastin e vleresimit dhe krahasimit të tenderëve ka konstatuar se ofertuesi "Europa Partners & ABC", nga Prishtina, e ka ofruar cmimin më të ulët në shumën prej 325,786.00€.

Komisioni ri - vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri - vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Baki Troni
- - Anëtar i komisionit - Besim Shala
- - Anëtar i komisionit – Fatmir Thaqi

Data e mbarimit të vlerësimit: 30.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....04.04.2017

Raporti i komisionit ri-vlerësues:

Nga tenderet e përgjegjëshëm që kanë ofertuar për "Ndërtimi i aneks objektit të Agjensise së Kosoves për Forenzikë – Faza II", pasi që kriter për dhënjen e kontratës është tenderi i përgjegjëshëm me cmimin më të ulët, komisioni i vleresimit me rastin e vleresimit dhe krahasimit të tenderëve ka

konstatuar se ofertuesi "Mercom Company", nga Prishtina, e ka ofruar cmimin më të ulët (pas llogaritjes se gabimeve aritmetike) në shumën prej 309,439.63 €.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi. 1 Autoriteti Kontraktues - "**Ministria e Punëve të Brendshme**", gjat këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike me vler të mesme. OE " **"Astraplan" shpk,** ka parashtruar ankes kundër njoftimit për dhënje të kontratës pas ri-vleresimit të ofertave. Kundrejt të njejtit njoftim parashtruesi i ankeses OE "Astra Plan"shpk, sipas përshkrimit më dt **18.04.2017**, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet ankimore se është bërë shkelje e dispozitave të LPP-së dhe atë nenit **7, 55, 56, 59, 64, 65, 66, 69** dhe **72**, të LPP-së, si dhe nenit **39.8**, të UOPP-së. Kundrejt të njejtës kërkesë AK – MPB, më datën **20.04.2017**, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën me arsyetin se pas ri-vleresimit të ofertave është rekomanduar për dhënje të kontratës operatori ekonomik i cili ka dorëzuar ofertë të përgjegjëshme me çmim më të lirë.

Sqarimi. 2 Pretendimet e palës në ankesë kanë të bëjnë edhe me mosrespektimin e vendimit të panelit shqyrties të datës. 28.02.2017, nr. 39-40-41/17 dhe mosrespektimin e disa kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit. Shkeljet e supozuara përmblidhen në disa pika të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dy ofertat paraprake të kualifikuara si të pergjegjëshme nga AK – MPB, pas ri-vlerësimit të ofertave.

Fillimishte po sqarojme pretendimet e perbashkëta, ku parashtruesi i ankeses potencon se paneli shqyrtues përmes vendimit të lartë përmendur ka aprovuar ankesat e OE "Mercom Company" dhe OE "Europa Partners" shpk, si pjesërisht të bazuara dhe atë vetëm për pjesën që ka të bëjë me buxhetit, ndersa AK, ka aplikuar nenin 72, të LPP-së, gjat rivlerësimit të ofertave e që një gjë e tillë nuk është kërkuar përmes vendimit të PSH-së,si dhe mos nenshkrimi i ofertave financiare sipas nenit 58.3, te LPP-se.

Perkunder faktit se vendimi i lartë përmendur nuk ka konstatuat përgjegjëshmërinë apo pa përgjegjëshmërinë e OE-ve, të lartë përmendur sqarojme se nenit 41, par 1, i rregullave të UOPP-se parashef një gjë të tillë "*...kur një vendim për ri-vleresim të ofertes bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshir një urdhër për ri-vleresim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënjes së kontrates nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar*". Për më tepër pika **II**, e dispozitivit të të njejtit vendim, ka kthyer këtë AP, në **ri-vleresim**, rrjedhimishtë AK -MPB, gjatë ri-vleresimit ka aplikuar nenin 72, të LPP-së, ku përmes letres standarde ka kërkuar sqarime shtesë, nërsa sqarimet e ofruara i ka trajtuar si të arsyeshme. Poashtu edhe pretendimi tjetër i përbashkët për mos respektim të paragrafit 3, të nenit 58, të LPP-së e kualifikojme si të pa bazuar pasi që ofertat financiare të të dy OE-ve, të ankimuar, rezultojnë të jenë të nënshkruara përgjat hapjes së ofertave.

Pretendimi tjeter kundrejt OE të rekomaduar për kontratë ka të bëjë me e-mailet. Sipas shkresave të lëndës kemi vërejtur se gjatë ri-vleresimit të ofertave komunikimi i AK-së, është bërë përmes emailit: robert.gegaj@mercomcompany.com, (adres e OE tanimë të rekomanduar për dhënje) ku edhe në raportin paraprak të ekspertizes kemi sqaruar se e njejta adresë është e përshkruar tek lista e OE-vë të interesuar, (pjesë e shkresave të lëndës së AK-së), ndërsa përgjatë vleresimit komunikimi është bërë përmes emailit, me përshkrimin, 'Mercom Company'. Poashtu lidhur me shkresen e OE, të

rekomanduar për dhënje, (sipas deklaratës në ankese) të ofruar nga "Yahoo", sqarojme se të njejtën shkresë nuk e posedojmë, (po supozojmë se e njejta shkresë është prezantuar në seancë dëgjimore, kundrejt ankesave paraprake tek paneli shqyrtues) rrjedhimishtë nuk mundemi të japim ndonjë vlersim konkret, për të njejtin pretendim.

Pretendimin tjeter, që ka të bëjë më mosnënshkrim të specifikacioneve teknike të detyrueshme, kundrejt ofertes së OE, të rekomanduar pas ri-vleresimit të ofertave, sqarojmë se specifikacionet teknike të detyrushme, jane kërkesë e AK-së,gjegjësisht të domosdoshme - detyruese për ofertuesit dhe se nga kendveshtrimi i dispozitave të LPP-së në fuqi, nuk kërkohet ndonjë nenshkrim i tyre. Megjithat, OE i rekomanduar për dhënje të kontrates pas ri-vleresimit të ofertave, në shkresa të lëndës, posedon deklaratën të nënshkruar dhe të vulosur, ku potencohet se kompania "Mercom Company"shpk, deklaron se specifikacionet teknike për punët e ofruara përputhen me ato të përmendura në aneksin **1**, të dosjes së tenderit.

Pretendim tjeter ankimore poashtu kundrejt ofertes së OE, të rekomanduar për kontratë ka të bëjë me vërtetimin tatimor, gjegjësisht me kërkesën e paraparë në pozicionin **b)**, të pikës **6.1**, të FDT-së, ku AK, tekstualisht ka kërkuar: "*Nje dokument nga administrata e tatimore e vendit tuaj te themelimit, **se ju nuk jeni me vonese per pagimin e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit para dates se publikimit te njoftimit te kontrates***". AK si dëshmi dokumentare për të njejtën kërkesë ka kërkuar: "*vertetim nga administrata tatimore (kopje)*. Kundrejt të njejtës kërkesë AK ka potencuar se e njejta duhet të dorëzohet vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënjes së kontratës. Në shkresa të lëndës së AK-së, ekziston shkresa – vërtetimi tatimor, në emër të "Mercom Company" shpk, sipas përshkrimit, arsyeja e lëshimit – aplikim për tender, me gjendje tatimore në ATK - përsoni është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borgjet tatimore të mbetura, duke potencuar se i njejti vertetim vlenë **90 ditë,** ndersa vula e protokollit përmban datën **04.04.2017**, ndërsa, publikimi i njoftimit për dhënje të kontratës në ueb faqen e KRPP-së, përmban daten **14.04.2017.**

Për të njejten situatë vleresimi ynë është që dëshmia dokumentare e ofruar nga OE, i rekomanduar për dhënje të kontrates nuk është konkrete, në raport me kërkesën, "..*se paku deri ne tremujorin e fundit **para dates se publikimit të njoftimit të kontrates***", pra nuk është e përshkruar periudha kohore sipas kërkesës së AK-së. Konkretisht njoftimi për kontratë i publikuar në krpp, përmban datën **07.11.2016**, ndërsa vula e protokollit të të njejtit vërtetim përmban datën **04.04.2017**. Për më tepër nenin 65, paragrafi 4 i LPP-së, sqaron kur një OE, nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit, gjegjësisht, paragrafi 4.8 shprehimisht thot: "*aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë*".

Sqarimi nr. 3. Në vijim po sqarojmë pretendimet kundrejt ofertës së OE "Europa Partners", i shpallur i përgjegjëshëm, por i pa suksesesshëm pas ri-vleresimit të ofertave. Pala në ankesë ka ngritur pretendime lidhur me formularin e tenderit pjesa "C". Për të njetën situatë sqarojmë se i njejti formular është i nënshkruar dhe vulosur nga anetaret e konzorcimumi, ndërsa parapmasa vetëm e nënshkruar, poashtu figuron emri i përfaqesuesit sipas marrëveshjes lider i konsorciumit "Europa Partners"shpk z. Mirsad Jetullahu, sipas përshkrimit në çertefikatën e regjistrimit të biznesit, rezulton të jetë drejtor i saj, rrjedhimishtë vleresimi ynë është që përshkrimi si i tillë, gjegjesisht paramasa dhe formulari i dorezimit të tenderit, të të njejtit OE i përmban të dhënat sipas paragrafit 3, të nenit 18, të rregullave të UOPP-se.

Pretendimi tjetër, ka të bëjë me kërkesën e parapar në pikën **9.1**, pozicioni nr. **2**: "*Operatoret ekonomik pjesmarres duhet te kene se paku **te ndertimeve ose renovimeve**, te realizuara ne tri vjetet e shkuara (**2013, 2014, 2015**)*", si dhe deshmia dokumentare e të njejtës kërkesë "*Listen e kontratave te puneve qe specifikojne: punet e kryera, shumen e kontrates, daten dhe pranuesin duke i bashkangjitur desheshmi certefikaten (certefikatat) e ekzekutimit te mire (kopje) ose reference (kopje) ose raport te pranimit teknik (kopje).* Në shkresa të ofertës, OE "Europa Partners'shpk, posedon listen e projekteve të realizuara, me gjithesej 27, pozicione të përshkruara, ndërsa si dëshmi dokumentare po përshkruajm dy rapaorte – pjesë e ofertës së të njejtit OE si në vijim:

- "Rindertimi i rruges Isa Kastrati – faza e tretë – raporti i përfundimit të punëve i datës 12/10/2015, në bazë të marrëveshjes me nr. 616 13 112 511, të datës 07/08.2013;
- "Ndertimi i rrugës magjistrale Prishtine – Gjilan – Krahu i djathtë te pompa e benzinës "Mili Petrol 2", ne Hajvali" – çertefikata mbi kryerjen e punëve e datës 03.10.2014, në bazë të marrëveshjës nr. 616 13 170 521, të datës 15.11.2016. Që të dy raportet sipas përshkrimit të lëshuara nga Komuna Prishtinë.

Perfundimisht në mbështetje të nenit 1 dhe 6, të LPP-së, dhe në mbështetjë të asaj që u tha më lartë, propozimi ynë për AK-MPB, është që lënda të ktheht në Ri-vleresim, me qëllim që të kërkohet sqarim sipas nenit 72, të LPP-së, kundrejt vertetimit tatimor të ofruar nga operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënje të kontratës pas ri-vlerësimit të ofertave, gjegjësisht të vërtetohen obligimet ngaj ATK-së, për periudhen kohore, siq është kërkuar në pikën 6.1, të FDT-së, pozicioni b).

Mendimi i ekspertëve të OSHP-së :

- Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521***, të inicuar nga AK – MPB, ta kthej në **RI-VLERESIM, ndërsa ankesën e OE "Astra Plan" shpk,** ta aprovoj si **të bazuar pjesërisht.**